

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Të nderuar kolegë,

Kam paraqitur një ndryshim ligjor, një amendament në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”, që ka të bëjë me shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale. Neni 1 i amendamentit, në tabelën 1 “Buxheti 2023”, sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore, në rreshtin e 13-të, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale në kolonën totale të shpenzimeve propozojmë që “vlera 78 milionë e 45 mijë e 728 lekë” të zëvendësohet “me vlerën 99 milionë e 800 mijë lekë”. Neni 2, ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit. Ky ndryshim ka si qëllim rritjen e financimit të sektorit shëndetësor, i cili ndër vite ka qenë i nënfinancuar.

Financimi ka si qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor që ofrohet, rritjen e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar, rritjen e investimit në infrastrukturat spitalore dhe qendrat shëndetësore, rritjen e pagave për mjekët, për infermierët dhe për stafet ndihmëse. Pra, propozojmë rritjen me 1% të GDP-së për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Efektet financiare do të përballohen nga ulja me të njëjtën masë të shpenzimeve operative qeveritare dhe kontratave koncensionare PPP.

Të nderuar kolegë, dua t’ju kujtoj për të disatën herë se paratë që parashikoni të mblidhni me buxhetin e shtetit nuk janë paratë tuaja, por janë paratë e shqiptarëve, janë paratë që dalin nga puna e përditshme e shqiptarëve, nga puna e sipërmarrjeve të vogla e të mëdha dhe nga puna e profesionistëve, pra janë ata që nga puna e tyre ua mundësojnë Shqipërisë këtë buxhet. Ju vetëm i menaxhoni dhe, duke qenë se thjesht i menaxhoni, duhet t’i menaxhoni mirë dhe në interes të atyre njerëzve. Shqiptarët duan dhe e meritojnë një shërbim shëndetësor cilësor. A e dini se një ndër arsye të pse shqiptarët emigrojnë është pikërisht shëndetësia?!

Prandaj, edhe ky parlament është mirë që paratë e shqiptarëve t’i çojë atje ku ka më shumë nevojë. Ju duhet ta dini dhe të mësoheni me idenë se shëndetësia nuk është mall tregu që tregtohet, sepse, po ta trajtojmë shërbimin shëndetësor si mall, i cili blihet në treg dhe po nuk pate para nuk mund ta përfitosh, atëherë do të shkaktojmë një katastrofë sociale. Shëndetësia duhet të financohet në mënyrë që edhe i

pamunduri, ai që nuk ka para për të paguar kur të shkojë në dyert e spitalit, të mos mendojë se ku do t'i gjejë paratë, por të marrë një shërbim shëndetësor, cilësor dhe, mbi të gjitha, një trajtim njerëzor.

Të nderuar kolegë, ju ftoj ta votoni këtë amendament në emër të qytetarëve që përfaqësoni dhe për qytetarët, në të kundërt sqarojini shqiptarët se nuk keni dëshirë ta përmirësoni cilësinë e shërbimit shëndetësor, sepse paratë ju duhen për t'ua shpërndarë bandave elektorale, që do të përdorni për zgjedhje dhe, mbi të gjitha, koncensionarëve tuaj. Të paktën, tregohuni një herë të sinqertë, mos nxirrni justifikime dhe mos manipuloni!